



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Kryesues i KD-së
Prof. dr. Ismet Salihu

Nr. Prot.: 3/573
Date: 29/11/2017

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", pas shqyrtimit të Kërkesë Nr.3/848 dt. 10.11.2017, të parashtruar nga Dr. Afrim Shabani asistent në Fakultetin e Mjekësisë katedra e Anatomisë, për pushim me pagesë për periudhën 29 nëntor deri më 29 dhjetor 2017. Në mbledhjen e mbajtur me datën 23.11.2017 merr, këtë:

V E N D I M

- I. Ass. Dr. Afrim Shabani asistent në Fakultetin e Mjekësisë katedra e Anatomisë, i lejohet pushimi me pagesë, gjatë vitit akademik 2017/18, për periudhën 29 nëntor deri më 29 dhjetor 2017, sipas kërkesës më nr. Prot. Nr. 3/848 dt. 10.11.2017.
- II. I përmenduri si në pikën I, të këtij vendimi shfrytëzimin e pushimit me pagesë për periudhën 29 nëntor deri më 29 dhjetor 2017 do të realizoj gjatë vitit akademik 2017/18, me qëllim të pjesëmarrjes në trajnimin që do mbahet në Sahai Hospital, Jaipur, ku do ketë qasje në ekzaminimin e pacientëve me matjet e meridianëve te kornese, në Indi.
- III. Ass. Dr. Afrim Shabani asistent në Fakultetin e Mjekësisë pushimi i lejohet me kusht që të paraqet para menaxhmenti të Fakultetit Mjekësiës, raportin mbi të arriturat gjatë periudhës së shfrytëzimit të pushimit dhe rezultatet e arritura në fushën përkatëse.
- IV. Menaxhmenti i Fakulteti të Mjekësisë në bashkëpunime me katedrën e anatomisë obligohen që të gjejnë zëvendësimin e duhur për orët dhe ushtrimet me të cilat i mban i përmenduri si më lart.
- V. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë, dhe benificione tjera nuk mbulon.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i UP-së, pasi e shqyrtoi kërkesën më nr. Prot. Nr. 3/848 dt. 10.11.2017, të parashtruar nga Dr. Afrim Shabani asistent në Fakultetin e Mjekësisë katedra e Anatomisë, për pushim me pagesë për periudhën 29 nëntor deri më 29 dhjetor 2017, me qëllim të pjesëmarrjes në trajnimin që do mbahet në Sahai Hospital, Jaipur, ku do ketë qasje në ekzaminimin e pacientëve me matjet e meridianëve te kornese, në Indi. KD-ja, e konsideroj të arsyeshme kërkesën për arsye se Universiteti i Prishtinës, përkrah krijimin e mundësive të performancës së stafit akademik në arritje shkencore, mundësi të cilat ndikojnë në ngritjen e cilësisë së tyre akademike, prandaj mbi këtë bazë KD-ja, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Dekanit të F. Mjekësisë;
3. Parashtruesit të Kërkesës;
4. Shërbimit financiar të F. Mjekësisë;
5. Zyrtarit Ligjor të KD-së.



Këshilli Drejtues i UP-së

Prof. Dr. Ismet Salihu - Kryesues